



Periodiku AMF – tani pranë jush

Listës së publikimeve të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare i është shtuar së fundmi edhe Periodiku AMF, një botim mujor elektronik i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare. Ky botim synon rritjen e transparencës dhe nivelit sistematik të komunikimit të AMF-së me tregjet, palët e interesuara dhe publikun në tërësi.

Periodiku do të përmbajë një larmi informacionesh dhe mesazhesh të rëndësishme mbi punën, projektet dhe prioritetet e AMF-së, zhvillimet e fundit në tregjet e sigurimeve, letrave me vlerë dhe pensione private suplementare të shoqëruara me problemet dhe sfidat me të cilat ato përballen.

Pasqyrimi i ndryshimeve në kuadrin ligjor nën dritën e direktivave Europiane, sfidat e përqasjes me metodën bashkëkohore të mbikëqyrjes me bazë riskun, të përfshirjes së standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit, çështje të bashkëpunimit me strukturat institucionale, tregjet dhe shoqatat profesionale në nxitjen e produkteve financiare, do të zënë vend shumë të rëndësishëm në mate-

rialet e periodikut.

Vëmendje e veçantë do t'u kushtohet informacioneve dhe zhvillimeve të fundit nga tregjet financiare ndërkombëtare, përfshirë këtu aktivitetet e organizatave ndërkombëtare të rregullatorëve në fushat e sigurimeve, letrave me vlerë dhe pensioneve.

Periodiku AMF, së bashku me publikimet e tjera informuese të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, do të krijojnë hapësira të reja drejt rritjes së nivelit të bashkëbisedimit me tregjet dhe transparencës me klientët e publikun, duke shërbyer në të njëjtën kohë për rritjen e vëmendjes dhe interesit të tyre kundrejt produkteve financiare jo – bankare, si domosdoshmëri për mirëqënien e tyre dhe zhvillimin ekonomik të vendit në tërësi.

Falenderoj stafin e AMF-së për realizimin e këtij botimi dhe i uroj punë të mbarë në realizimin e numrave të mëtejshëm të periodikut.

Elisabeta Gjoni
Kryetare

Në këtë numër:

Sistemi GSRM

2

Vështrim
mbi tregun
e sigurimeve
Janar- Tetor 2007

4

Konferenca XIV
Vjetore
e IAIS-it

5

Ngjarje dhe
zhvillime
të tjera

6

Parime
të IAIS-it
ICP 25 - Mbrojtja
e Konsumatorit

7

Ç'është GSRM

GSRM¹ (Tregu me Pakicë i Letrave me Vlerë të Qeverisë) është një sistem elektronik ku publikohen të dhënat mbi kuotimet dhe transaksionet e ekzekutuara çdo ditë në tregun me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë (bono thesari dhe obligacione qeveritare) nga subjektet e licencuara prej Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (AMF) për të operuar në këtë treg.

GSRM është ideuar dhe konceptuar nga AMF në formën e një platforme të përbashkët të shpërndarjes së informacionit nëpërmjet publikimit të detyrueshëm të të dhënave mbi veprimet e ekzekutuara nga operatorët në tregun me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë.

Qëllimi i Futjes në Zbatim të GSRM

Qëllimi i futjes në zbatim të GSRM është për t'i ardhur në ndihmë publikut edhe investitorëve institucionalë, të cilët kanë investuar në letrat me vlerë të Qeverisë, të kenë një informacion më të plotë dhe në kohë reale mbi kërkesën dhe ofertën ditore për këto instrumente (bono thesari dhe obligacione qeveritare) në tregun me pakicë, i cili organizohet në sportelet e operatorëve të licencuar, kryesisht banka të nivelit të dytë.

Me futjen në zbatim të GSRM, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare synon rritjen e transparencës në tregun me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë duke synuar një mbrojtje më të mirë të interesave të investitorëve.

¹ Government Securities Retail Market – Tregu me Pakicë i Letrave me Vlerë të Qeverisë

Avantazhet e GSRM

GSRM sjell këto avantazhe:

- ▶ Rrit transparencën në tregun me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë;
- ▶ Krijon mundësinë e informimit të vazhdueshëm e në kohë reale të investitorëve;
- ▶ Rrit konkurrencën mes operatorëve në treg;
- ▶ Zvogëlon kostot operationale të tregtimit në letra me vlerë të Qeverisë;
- ▶ Zvogëlon mundësinë e abuzimeve në treg;
- ▶ Krijon mundësi për një mbrojtje më të mirë dhe më efikase të investitorëve;
- ▶ Krijon premiset për zhvillimin e mëtejshëm të tregut sekondar të letrave me vlerë.

Karakterit Publikues i të Dhënave në GSRM

Subjektet e licencuara për të operuar në tregun me pakicë janë të detyruara të publikojnë në GSRM të dhënat ditore mbi kuotimet dhe transaksionet e ekzekutuara në letra me vlerë të Qeverisë, sipas afateve specifike të maturimit.

Kujdes: Të dhënat e publikuara në GSRM kanë vetëm karakter “informues” dhe jo “detyrues”. Kjo do të thotë që operatorët e licencuar nga AMF, ruajnë të drejtën për të negociuar me klientët e tyre në mbi çmimin, sasinë apo çdo të dhënë tjetër që ka lidhje me transaksionet në tregun me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë.

GSRM

Tregu me Pakicë i Letrave me Vlerë të Qeverisë Government Securities Retail Market

TREGTIMI Data 30/11/2007

► **Kuotimet & Transaksionet Ditore**
 • Lloji B, C
 • Lloji A, D, E


► **Të Gjitha Kuotimet për një Letër me Vlerë të Caktuar**

Maturimi

DDM

Ndërmjetësi Financiar

Lloji i Transaksionit



Ditore Lloji B, C

Blerje	Shitje	Dt. Mat.	DDM	Kupon ¹	Lloji Trans.	Totali i Trans. Ditore	Ndryshimi i Fundit
Thesari - 3 Muaj							
6,05 %	-	10/01/2008	41	-		-	13/11/2007 09:50:39
Thesari - 6 Muaj							
7,60 %	6,00 %	08/05/2008 16:48:42	160	-		-	12/11/2007 09:09:46
7,75 %	-	24/04/2008	146	-		-	02/11/2007 11:17:47
7,55 %	5,90 %	24/04/2008	146	-		-	08/11/2007 09:05:45
7,35 %	-	10/04/2008	132	-		-	13/11/2007 09:51:35
Mbyll 6,50 %	5,50 %	28/02/2008 10:17:28	90	-		-	16/11/2007 13:53:17
Bono Thesari - 12 Muaj							

Kurset
 ► EURO / LEK 121,12

Arkiva e të dhënave

GSRM do të përfshijë edhe një bazë të dhënash, e cila do t'i vijë në ndihmë personave të interesuar për të kërkuar në historikun e të dhënave të tregtimit të letrave me vlerë të Qeverisë.

Duke filluar nga data 1 Nëntor 2007 deri në datën

1 Dhjetor 2007 ky projekt do të jetë në fazë testimi, por të dhënat e futura do të jenë reale. Pas kësaj date sistemi GSRM do të jetë i hapur për të gjithë publikun i cili mund të shikojë në faqen e internetit të Autoritetit www.amf.gov.al në linkun GSRM rezultate të përdorimit të tij.

Vështrim mbi tregun e sigurimeve


Një nga ngjarjet më të rëndësishme në tregun shqiptar të sigurimeve gjatë vitit 2007 është hyrja e investitorëve të huaj si partnerë strategjikë të shoqërive shqiptare të sigurimit. Emra si ASPIS Group, UNIQA Austria dhe Vienna Insurance Group tashmë janë partnerë të shoqërive shqiptare të sigurimit, përkatësisht Interalbanian sh.a., Sigal sh.a., dhe Sigma sh.a. Prezenca dhe interesimi në rritje i investitorëve të huaj dëshmon për mundësitë e mëdha të zhvillimit që ky treg rezervon në të ardhmen dhe përforcon faktin e krijimit të një ambjenti të përshtatshëm

investimesh në tregun shqiptar të sigurimeve. Në periudhën Janar – Tetor 2007, primet e shkruara bruto arritën masën prej rreth 5 miliardë lekë, përkundrejt shifrës rreth 3.6 miliardë lekë të realizuar në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Rritja prej 37.46% e tregut tregon përmirësim të dukshëm në raportin e rritjes, që në vitin 2006 ka qenë rreth 12%, ndërsa mesatarja e 5 viteve të fundit rreth 4.5%. Në periudhën 10 – mujore 2007, vërehet rritje e ngjashme në primet e sigurimeve të detyrueshme (37.93%) me primet e sigurimeve vullnetare (36.56%). Në 10 – mujorin e vitit 2007 u lidhën rreth 424 mijë kontrata sigurimi. Vlen të përmendet rritja prej 71% e numrit të kontratave në sigurimin e jetës kundrejt të njëjtës periudhë të vitit të kaluar.

Tabelë: Volumi i primit të shkruar bruto në periudhën janar - tetor (2006-2007)

Lloji i sigurimit	Vlera (në mijë lekë)	
Periudha Janar - Tetor	2006	2007
A) Sigurime të detyrueshme	2,377,292	3,279,060
B) Sigurime vullnetare	1,236,212	1,688,194
<i>nga këto</i>		
a) Sigurimi i jetës	239,771	325,844
b) Sigurimi i jojetës	996,441	1,362,350
Total	3,613,503	4,967,254


Grafik: Volumi i primit të shkruar bruto në periudhën janar - tetor (2006-2007)



Tabelë: Investitorët e huaj në tregun shqiptar të sigurimeve

Investitorët	Në partnership me	Data
ASPIS Group	Interalbanian sh.a.	Prill 2007
UNIQA Austria	Sigal sh.a.	Korrik 2007
Vienna Insurance Group	Sigma sh.a.	Gusht 2007

Tabelë: Pjesmarja e shoqërive në tregun e sigurimit për periudhën Janar- Tetor 2007 (Jo-Jeta)



Konferenca XIV Vjetore e IAIS-it

Shoqata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve të Sigurimeve (IAIS) organizoi më 16-19 Tetor 2007 Konferencën XIV Vjetore të saj. Përfaqësues nga 130 vende u mbledhën në Fort Lauderdale, Florida, për të diskutuar çështje të rëndësishme të legjislacionit të sigurimeve dhe të rolit të rëndësishëm të sigurimeve përballë sfidave globale të ditëve tona të lidhura me ndryshimet klimaterike, pasiguritë ekonomike, globalizimin, etj. Në Konferencë mori pjesë edhe një ekip i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare i drejtuar nga Zj. Elisabeta Gjoni – Kryetare.

Raportimet nga Komitetet dhe Nënkomitetet e IAIS-it

Në Konferencat vjetore të IAIS-it përcaktohen prioritetet në lidhje me veprimtarinë e organizatës dhe zhvillimin e tregjeve. Në funksion të realizimit të detyrave dhe në përputhje me prioritetet e përcaktuara, ngrihen Komitete dhe Nënkomitete të ndryshme. Shqipëria është pjesëmarrëse aktive në nënkomitetin e Bazës së të Dhënave të Legjislacionit të Sigurimeve. Në raportimin e këtij nënkomiteti, në 14 Tetor 2007 u trajtuan çështje të funksionimit të Bazës së të Dhënave, mundësitë e rritjes së numrit të kontribuesve, rritja e efektivitetit të përdorimit nga rregullatorët në mbarë botën dhe hartimi i raportit përfundimtar të vitit 2007 të Nënkomitetit. Komitete dhe nënkomitete të tjera aktualisht po trajtojnë çështje të veçanta ku mund të përmendim: mbikëqyrjen e grupeve financiare, çështje të rregullimit dhe mbikëqyrjes së risigurimeve, qeverisjen e shoqërive, standardet e aftësisë paguese dhe kapitalit, etj. Raportet e hartuara nga grupet e punës përmbajnë rekomandime

të cilat pas shqyrtimit dhe arritjes së konsensusit të plotë, shndërrohen në standarde të IAIS-it.

Çështje të rëndësishme të trajtuara në Konferencën e XIV

Në Konferencë u theksua se roli i mbikëqyrësve në tregun e sigurimeve është jetik kur flitet për ngritjen e standardeve, apo minimizimin e rrisqeve. Zgjerimit të tregjeve financiare të ditëve të sotme i nevojitet një sistem rregullativ ndërkombëtar i njësuar, që do të përcaktojë emëruesin e përbashkët të rregullimit ligjor në sigurime dhe do të mundësojë trajtimin konsistent të elementëve të ngjashëm në juridiksione të ndryshme në mbarë Botën. Kryetari i Komitetit Ekzekutiv të IAIS-it, Z.Flamee, theksoi se “mbikëqyrësve do t’u duhet të gjejnë raportin e duhur midis zhvillimit të tregut dhe ruajtjes së qëndrueshmërisë financiare, çfarë do të çojë në përmirësimin e rregullimit dhe mbikëqyrjes si në nivel kombëtar, ashtu edhe në atë ndërkombëtar. Gjetja dhe arritja e këtij raporti kërkon efektivitet dhe pavarësi politike të rregullatorëve, një kombinim të drejtë të parimeve dhe rregullave brenda sistemit dhe një mbikëqyrje efektive të bazuar tek rreziku”. Bashkëpunimi dhe bashkëveprimi më i madh midis tregjeve është çelësi për të arritur në njësimin e rregullave botërore dhe krijimin e një sistemi të njëjtë të matjes së aftësisë paguese të shoqërive të sigurimit. Një sipërmarrje e tillë do të kërkojë hapa konkretë që përmbajnë përdorimin e “testeve të stresit”, krijimin e sistemeve zinxhir dhe përcaktimin e shumës unike të Kapitalit Minimal të Kërkuar për të gjithë botën. Hap i mëtejshëm në realizimin e bashkëpunimit efektiv janë marrëveshjet dypalëshe (MRA). IAIS është tashmë në procesin e zhvillimit të një Marrëveshjeje Shumëpalëshe të Mirëkuptimit. Krijimi i hapësirave



për mbikëqyrjen “me bazë parimet” dhe ndërthurja e drejtë me mbikëqyrjen “me bazë rregullat” do të ndihmojë mbikëqyrësit të evidentojnë rreziqet që në fazën fillestare të shfaqjes së tyre.

Në Konferencë pati një mori prezantimesh interesante që kanë të bëjnë me të ardhmen e zhvillimit ekonomik, transferimin e rrezikut ndërmjet sektorëve të ndryshëm financiarë, pasojat e ndryshimeve klimaterike dhe paparashikueshmërinë e tyre, të lidhura ngushtë me efektet që ato sjellin në industrinë e sigurimeve.

Me interes u ndoq edhe prezantimi i një programi të IAIS-it për edukimin dhe trainimin e mbikëqyrësve. Ky program synon të ofrojë kurse trainimi on-line për rregullatorët, që do të shoqërohet me çertifikatat përkatëse pas përfundimit me sukses të këtyre trainimeve.

Konferenca XV e IAIS-it

Ne mbyllje të Konferencës të XIV, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare të Hungarisë, nëpërmjet një prezantimi të veçantë, njoftoi mbajtjen e Konferencës XV të IAIS-it në Budapest, Hungari në 14 – 17 Tetor 2008. Në fokusin e kësaj Konferencë, përveç sfidave klasike si psh: unifikimi ndër-sektorial, harmonizimi i legjislacionit dhe reduktimi i kostove të rregullimit ligjor, do të trajtohen edhe çështje të ndërmjetësimit në sigurime dhe të veprimtarisë sigurorese on-line.

Ngjarje dhe zhvillime të tjera

Organizata Ndërkombetare e Komisionit të Letrave me Vlerë (IOSCO²) zhvilloi në Madrid, Spanjë më 14-17 Tetor 2007 një trainim për fazat e tranzicionit të Standarteve Ndërkombetare të Raportimit Financiar (IFRS³). Në këtë trainim u trajtuan çështje të rëndësishme lidhur me vështirësitë që paraqet kalimi nga aplikimi i standarteve lokale të kontabilitetit në Standartet Ndërkombetare të Raportimit Financiar (IFRS). Përvoja e sjellë nga vende të ndryshme tregon domosdoshmërinë e përshtatjes së kuadrit ligjor të shoqëruar me trainimin e stafëve që do aplikojnë sistemin IFRS. Në ndihmë të kontabilistëve vjen edhe faqja e internetit <www.iasplus.com>, me akses të lirë për leximin apo printimin e manualeve të hartuar nga kompania audituese Deloitte.

Temat e trajtuara

- ▶ *Procesi i implementimit të sistemit IFRS në Komunitetin Europian - referuar nga përfaqësues i Autoritetit Mbikëqyrjes në Francë;*
- ▶ *Përvoja të Hollandës dhe Kinës në implementimin e sistemit të ri dhe probleme të tranzicionit;*
- ▶ *Raste të disiplinimit në Francë dhe Portugali të shoqëruara me shembuj konkretë prej këtyre vendeve;*
- ▶ *Tranzicioni drejt Standarteve të reja duke e parë nën prizmin e auditorëve – referuar nga KPMG UK Partner;*
- ▶ *Implementimi i IFRS në tregjet në zhvillim, problemet specifike, me të cilat përballen mbikëqyrësit në këto tregje.*

² International Organization of Securities Commissions (Organizata Ndërkombetare e Komisioneve të Letrave me Vlerë)

³ International Financial Reporting Standards (Standarde Ndërkombetare të Raportimit Financiar)

Parime të IAIS-it ICP 25 - Mbrojtja e Konsumatorit

Parimi nr. 25

ICP⁴ 25: (Parimet Themelore të Sigurimeve 25). Mbrojtja e Konsumatorit

IAIS vendos parime që janë themelore për mbikëqyrjen efektive të tregut të sigurimeve. Parimet identifikojnë çështjet më të rëndësishme, që duhet të trajtohen nga Autoriteti Mbikëqyrës i sigurimeve dhe që formojnë bazat për zhvillimin e mëtejshëm të standarteve.

IAIS ka përcaktuar 28 parime kryesore (ICP- Insurance Core Principles). Në numrin e parë të këtij periodiku do të trajtojmë Parimin nr. 25 që i përket “Mbrojtjes së Konsumatorit”, meqënëse “Mbrojtja e Konsumatorit” bën pjesë në objektivat parësore të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare.

ICP 25: (Parimi themelor 25) Mbrojtja e konsumatorit

Autoriteti Mbikëqyrës vendos minimumin e kriterëve për shoqëritë e sigurimit si dhe ndërmjetësit në sigurime nën juridiksion, ku përfshihen marrëveshjet e tyre me konsumatorin dhe shitjet e produkteve të kompanive të huaja të sigurimeve jashtë kufijve. Kriteret përfshijnë përgatitjen në kohë të informacionit përkatës për palët përpara se sa kontrata të fillojë, deri në atë pikë sa të gjitha detyrimet e kontratës të jenë plotësuar.

Sqarim

Kriteret për ushtrimin e veprimtarisë së biznesit të sigurimeve ndihmojnë në forcimin e besimit të konsumatorit në tregun e sigurimeve.

Autoriteti Mbikëqyrës u kërkon shoqërive të sigurimit dhe ndërmjetësve të sigurimeve t'i trajtojnë konsumatorët e tyre në mënyrë sa më të drejtë, duke i kushtuar vëmendje nevojave të tyre për informacion. Në lidhje me konsumatorët nën juridiksion, Autoriteti Mbikëqyrës duhet të vendosë kriteret dhe kushtet, të cilat duhet të plotësohen nga kompanitë e sigurimeve si dhe nga ndërmjetësit në sigurime. Kriteret dhe kushtet e aplikueshme për shitjet jashtë vendit duhet të jenë të qarta.

Një proces i mirë i pagesës së dëmeve është esencial në trajtimin e drejtë dhe të ndershëm të konsumatorëve. Për këtë qëllim, disa juridiksione kanë krijuar disa mekanizma të tjerë ligjore për lehtësimin e këtij procesi, siç janë panellet e pavarura, apo arbitrazhet. Për një numër të madh konsumatorësh, produktet e sigurimit janë të vështira për t'u kuptuar dhe për t'u vlerësuar. Shoqëritë e sigurimit dhe ndërmjetësit në sigurime kanë njohuri më të thella për fushën e sigurimeve sesa konsumatorët.

Marrëveshje duhet të ekzistojnë edhe për policmbajtësit e ardhshëm në mënyrë që:

- ▶ Të kenë mundësi për t'u njohur me të gjithë informacionin e domosdoshëm, për të marrë një vendim sa më të saktë përpara nënshkrimit të kontratës.
- ▶ Të jenë të informuar për të drejtat dhe detyrimet e tyre përsa kohë zgjat kontrata.

⁴ Insurance Core Principles – Parimet Themelore të Sigurimeve

Këto kritere duhet të jenë të ndryshme për konsumatorë të ndryshëm. Në veçanti, rregullat e detajuara për ushtrimin e biznesit mund të mos jenë të përshtatshme për transaksionet e risigurimeve, ose për konsumatorët profesionalë.

Kriteret BAZË

Autoriteti Mbikëqyrës kërkon nga shoqëritë e sigurimeve dhe nga ndërmjetësit në sigurime të veprojnë me aftësitë e duhura, me kujdes dhe me vëmendje në marrëveshjet e tyre me konsumatorët.

Autoriteti Mbikëqyrës kërkon nga shoqëritë e sigurimeve dhe ndërmjetësit të zhvillojnë politika se si t'i trajtojnë sa më mirë konsumatorët dhe të kenë sisteme, si dhe trainime për të siguruar përputhshmërinë me këto politika nga nëpunësit e tyre si dhe shitës të tjerë bashkëpunues.

Autoriteti kërkon nga shoqëritë e sigurimeve si dhe nga ndërmjetësit në sigurime të kërkojnë informacionin e duhur nga klientët e tyre, me qëllim që të vlerësojnë sa më mirë nevojat e tyre për sigurim, përpara se sa të japin këshilla ose të nënshkruajnë kontratën e sigurimit.

Autoriteti vendos kritere për shoqëritë e sigurimit dhe ndërmjetësit në sigurime, përsa i përket përmbajtjes së informacionit, si dhe periudhës kohore në të cilën jepet informacioni

(i) për produktin, duke përfshirë dhe rreziqet që e

shoqërojnë, përfitimet, detyrimet dhe pagesat. (ii) për çështje të tjera që lidhen me shitjen, duke patur parasysh mundësinë e ekzistencës së konfliktit të interesit për policmbajtësit që shoqëria ka ose mund të ketë.

Autoriteti kërkon nga shoqëritë e sigurimeve dhe nga ndërmjetësit në sigurime të trajtojnë kërkesë-pagesat e policmbajtësve për dëme dhe ankesat e tyre në mënyrë sa më efektive, të ndershme, nëpërmjet një procesi-zgjidhjeje transparent dhe të barabartë.

Kriteret e AVANCUARA

Autoriteti Mbikëqyrës kërkon nga shoqëritë e sigurimeve dhe ndërmjetësit në sigurime, të vendosin rregulla për trajtimin e informacionit mbi konsumatorin dhe t'i kushtojnë shumë kujdes mbrojtjes së informacionit konfidencial të konsumatorit.

Autoriteti Mbikëqyrës jep informacion në publik, nëse legjislacioni lokal aplikohet për produktet e sigurimit jashtë kufijve, si për shembull produktet e sigurimit e-commerce. Autoriteti Mbikëqyrës publikon njoftime paralajmëruese për konsumatorët, nëse është e nevojshme për të parandaluar transaksione me kompani të pa-mbikëqyrura.

Autoriteti i Mbikëqyrjes mundëson dhe promovon ndërgjegjësimin dhe njohjen e konsumatorëve me kontratat e sigurimeve.